




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 02/L-52 Mbi edukimin parashkollor dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 17.04.2020, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

PËR LIRIM NGA PAGESA E TARIFAVE NË INSTITUCIONIN PËR EDUKIMIN DHE ARSIMIMIN PARASHKOLLOR PUBLIK NË LIPJAN

Neni 1

Me këtë Vendim LIROHEN nga pagesa e tarifave për qëndrim ditor (participim) në institucionin për edukimin dhe arsimimin parashkollor publik për vitin 2020 duke llogaritur nga dita e ndërprerjes së procesit edukativo-arsimor për të gjithë prindërit për fëmijët e tyre për shkak të mosfunksionimit të institucionit (qerdhes publike) për arsye të shfaqjes së pandemisë COVID-19.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15Nr. 400-16850

Lipjan, më 17.04.2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

